



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 430/14 Prot.

Tiranë, më 12.03.2021

VENDIM

Nr. 30, datë 12.03.2021

PËR
MIRATIMIN E PËRCJELLJES SË DOKUMENTACIONIT
TË DOC.DR. EDMOND BIÇOKU PËR FITIMIN E TITULLIT “PROFESOR I
ASOCIUAR” PRANË KPPA

Mbështetur në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të RSH”, në VKM nr.112, datë 23.2.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor””, i ndryshuar, në VKM nr.27, datë 29.1.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, si dhe në Vendimin e Senatit Akademik të UST-së nr.42, datë 27.11.2020 “Për vijimin e procedurave të vlerësimit të aplikimeve për fitimin e titujve akademikë në Universitetin e Sporteve të Tiranës”; Senati Akademik i UST-së, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2021,

V E N D O S I:

1. Të miratojë përcjelljen e dokumentacionit të ardhur nga FVFR me nr.405/1 Prot., datë 28.3.2021, të Doc.Dr. Edmond Biçoku për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar”, pranë Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST-së.
2. Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik vijon me procedurat sipas kuadrit ligjor në fuqi.
3. Një kopje e këtij Vendimi i përcillet Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik, si dhe Njësisë Kryesore, Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit në UST.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof.Dr. AGRON KASA

